

**Marsel Llukmani**

**Propozuar nga Biznes Albania**

Marsel Llukmani ka përfunduar studimet Bachelor dhe Master në Inxhinieri Ndërtimi pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin Politeknik të Tiranës. Aktualisht shërben si Menaxher Projektesh në Biznes Albania dhe mban njëkohësisht dhe rolin e Drejtuesit Teknik në sektorin privat të ndërtimit, me specializim në inxhinierinë e ndërtimit.

Aktualisht Koordinator i Projektit "Qëndrueshmëria periferike: Modeli i ekonomisë qarkulluese për fuqizimin e produkteve lokale," një projekt ndërkufitar midis Rajonit të Puglias, Qarkut të Vlorës, Bashkisë së Vlorës, Bashkisë Himarë, Provincës së Leçes, Komunës së Casalvecchio di Puglia, Gruppo di Azione Locale (G.A.L.) Meridaunia dhe Biznes Albania.

Drejtues Projekti për: "Vision Multimedia Room" të bashkëpunimit Italo-Shqiptar, një galeri multimediale dixhitale e projektuar dhe prodhuar nga Biznes Albania në bashkëpunim me Bashkinë e Vlorës dhe AICS. Me përdorimin e teknologjive dixhitale 3D, kjo galeri ofron një përvojë unike dhe një qasje të re për eksperiencat turistike në qytetin e Vlorës.

Gjithashtu ideator, projektues dhe zbatues i projektit SET-TourLAB, një laborator inovativ i turizmit për qytetin e Vlorës.

Marsel Llukmani është bashkëautor i librit "Modul Trajnimi: Laboratori i Sipërmarrjeve në Turizëm" me mbështetjen e Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim.